



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:319050
Datë: 08.01.2025
Numri i dokumentit: 06686034

C.nr.3785/2024

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Skender Shala me praktikanten e kësaj gjykate Donika Parduzi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.M nga M, të cilin e përfaqëson Elvir Imer av. me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës K.M-DF, baza e kontestit: *Kompensim i shujtave ditore*, vlera e kontestit: 620.00 euro, jashtë seance gjyqësore me datë 08.01.2025, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.M nga M, ashtu që DETYROHET e paditura K.M-J, që paditësit, në emër të kompensimit të shujtave për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 01.01.2023 e deri me 31.12.2023 apo për 248 ditë pune “nga 2.50 euro dita”, t’ia paguaj shumën e përgjithshme të detyrimit prej 620.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 11.10.2024, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën përfundimtare të detyrimit, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. OBLIGOHET e paditura K.M-J qe paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumen prej 124 euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit me padi të datës 21.10.2024, ka kërkuar që të detyrohet e paditura K.M-J-DF, që paditësit, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën kohore 01.01.2023 deri me 31.12.2023 apo për 248 dite pune (për secilën ditë të punës nga 2.50 euro), të ja paguaj shumën e tërësishme prej 620.00 euro, konform vendimit të nxjerr nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, ku me dt. 30.11.2022 ka nxjerr Vendimin nr. 02-060/01-0104125/22-7 për lejimin e pagesës së shujtave për punonjësit e administratës komunale nga “2.50 euro” për ditë pune për vitin 2023, i njëjti vendim më pas u plotësua me Vendimin nr. 02-060/01-0111396/22-7 i datës 27.12.2022 i cili e specifikon se pagesa do të kryhet nga buxheti i Komunës për vitin 2023 duke u mbështetur në kategoritë ekonomike për paga dhe mëditje, ndërsa me datë 03.02.2023 me vendimin nr. 02-060/01-0006466/3-23 vendim i cili u publikua me datë 27.02.2023, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë, deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 15.11.2024, të cilin e paditura e ka pranuar me dt. 22.11.2024 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në

padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadi nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadi del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë: Akt emërimi i datës 23.06.2020, në të cilin vërtetohet fakti se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe mban pozitën: Zyrtar i lartë Ligjor, nga Vendimi nr. 02-060/01-0104125/22-7 i datës 30.11.2022, për lejimin e pagesës së shujtave për punonjësit e administratës komunale nga “2.50 euro” për ditë pune për vitin 2023, i njëjti vendim më pas u plotësua me Vendimin nr. 02-060/01-0111396/22-7 i datës 27.12.2022 i cili e specifikon se pagesa do të kryhet nga buxheti i Komunës për vitin 2023, ndërsa me datë 03.02.2023 me vendimin nr. 02-060/01-0006466/3-23 vendim i cili u publikua me datë 27.02.2023, ku për periudhën kohore 01.01.2023 e deri me 31.12.2023, paditësja ka qenë në punë për 248 ditë pune “nga 2.50 euro dita”, e që në total del shuma prej 620.00 euro.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 11.10.2024), e ku lartësia e kamatës vjetore është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 104 € për përpilim padisë si dhe 20 € ne emër te taksës gjyqësore për padi.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i’u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c te LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 parg.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3785/2024 dt.08.01.2025

Gjyqtari
Skender Shala

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.